

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 8 dhjetor 2010

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretar: Z. John Hocking

Vendim i datës: 8 dhjetor 2010

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI KËRKESËN E LAHI BRAHIMAJT
PËR LIRIM TË PËRKOHSHËM ME KUSHT**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të Mbrojtjes:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Collen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Tribunali”) ka marrë “Kërkesën për Lirim të Përkohshëm me Kusht Paraqitur prej të Akuzuarit Lahi Brahimaj”, dorëzuar më 26 nëntor 2010 (“Mocioni”).

A. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 21 korrik 2010, Dhoma e Apelit shfuqizoi vendimin e Dhomës Gjyqësore për shpalljen e pafajësisë së Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt (“I Akuzuari”) lidhur me disa pika të Aktakuzës dhe urdhëroi rigjykimin e tyre për këto pika.¹ Dhoma e Apelit gjithashtu urdhëroi mbajtjen në paraburgim të Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimajt dhe urdhëroi Komandantin e Njesisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara në Hagë që t’i mbante në paraburgim deri në një urdhër tjetër.²

2. Më 26 nëntor 2010, i Akuzuari dorëzoi “Kërkesën për Lirim të Përkohshëm paraqitur prej të Akuzuarit Lahi Brahimaj” (“Mocioni”). Më 3 dhjetor 2010, Prokuroria dorëzoi “Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Dytë të Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm” (Përgjigje”). Më 8 dhjetor 2010, i Akuzuari dorëzoi konfidencialisht “Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mocionin e Dytë të Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Shtojcën A dhe Shtojcën konfidenciale B, me Kërkesë për Leje për Kundërpërgjigje”.

3. Më 3 dhjetor 2010 Ministria e Punëve të Jashtme holandeze dorëzoi një letër. Më 29 nëntor 2010, Dhoma Gjyqësore nxori “Kërkesë drejtuar EULEX-it për Parashtrime mbi Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht”. Më 6 dhjetor 2010, EULEX-i dorëzoi letërpërgjigjen.

B. PARASHTRIMET

1. Mocioni

¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 377. Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykimin e Ramush Haradinajt dhe Idriz Balajt për pikat 24, 26, 28, 30, 32 dhe 34 të Aktakuzës dhe rigjykimin e Lahi Brahimajt për pikat 24, 26, 30 dhe 34 të Aktakuzës.

4. I Akuzuari kërkon prej Dhomës Gjyqësore miratimin e lirimit të përkohshëm për periudhën 20 dhjetor 2010 – 10 janar 2011 me të njëjtat kushte si të mëparshmet ose me kushte të tjera që Dhoma Gjyqësore do t'i konsiderojë të përshtatshme.³

5. I Akuzuari parashtroi se ka respektuar kushtet e lirimit të përkohshëm të mëparshëm.⁴

6. I Akuzuari argumenton se në “Vendimin mbi Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm” të datës 10 shtator 2010 (“Vendimi i shtatorit 2010”), Dhoma Gjyqësore u bind se ai do t'i dorëzohej Tribunalit kur të urdhërohej ta bënte këtë.⁵

7. I Akuzuari argumenton se ai ka provuar me sjelljen e tij në të kaluarën gjatë gjithë procesit se do të kthehet për rigjykimin e pjesshëm në momentin që do të urdhërohet.⁶ Ai thekson se lidhjet e tij me Kosovën janë më të forta se kurrë dhe se aktualisht ai është i regjistruar në fakultetin e drejtësisë.⁷

8. I Akuzuari parashtroi se rrethanat nga Vendimi i Shtatorit 2010 tashmë kanë ndryshuar dhe se nuk ekziston rrezik për dëshmitarët, viktimat apo persona të tjerë.⁸ Ai më tej argumenton se në vendimin në fjalë, Dhoma Gjyqësore i ka kushtuar rëndësi të veçantë kohëzgjatjes së lirimit të përkohshëm që kërkohej.⁹ I Akuzuari kërkon lirim të përkohshëm për një periudhë të kufizuar trejavëshe dhe argumenton se shqetësimet e ngritura prej Dhomës Gjyqësore në Vendimin e Shtatorit 2010, janë davaritur pak a shumë.¹⁰

9. I Akuzuari rikujton konkluzionin e mëparshëm të Dhomës së Apelit se lirimi i tij i përkohshëm në të kaluarën asnjëherë nuk ka përbërë rrezik për viktimat ose dëshmitarë.¹¹ Ai thekson se Dhoma e Apelit konkludoi shprehimisht se Prokuroria nuk kishte paraqitur “prova” se ai “do të orvatet të frikësojë dëshmitarë”.¹² I Akuzuari më tej parashtroi se dy dëshmitarët e mundshëm që përmenden në Aktgjykimin e Apelit nuk jetojnë në Kosovë dhe

² Aktgjykimi i Apelit, para. 377.

³ Mocioni, para. 2.

⁴ Mocioni, para. 11-13.

⁵ Mocioni, para. 20; Vendimi i Shtatorit 2010, para. 29.

⁶ Mocioni, para. 21.

⁷ Po aty, para. 22.

⁸ Po aty, para. 25.

⁹ Po aty, para. 26.

¹⁰ Po aty, para. 27.

¹¹ Po aty, para. 28.

¹² Po aty, para. 29.

se nuk ka prova se ai përbën rrezik konkret për ndonjë dëshmitar të mundshëm, sidomos kur kërkon lirim të përkohshëm “vetëm për disa javë” dhe kur dëshmitarët e mundshëm nuk jetojnë në Kosovë.¹³

10. I Akuzuari thekson se Dhoma Gjyqësore duhet të marrë parasysh përmbushjen e kushteve të liritimit të përkohshëm prej tij për më shumë se një vit.¹⁴

11. I Akuzuari kërkon prej Dhomës Gjyqësore që t’i kërkojë EULEX-it të konfirmojë se është sërish i gatshëm të mbikëqyrë përmbushjen e kushteve të liritimit të përkohshëm prej tij.¹⁵

2. Përgjigje

12. Prokuroria kundërshton Mocionin për shkak të rrezikut konkret që lirimi i të Akuzuarit do të përbënte për dëshmitarët.¹⁶ Ajo më tej parashtrohet se duke marrë parasysh “atmosferën e pashoqe të frikësimit të përhapur dhe të rëndë të dëshmitarëve” së bashku me publicitetin në lidhje me lirimimin e përkohshëm të të Akuzuarit, lirimi i përkohshëm i tij do të rrezikonte të komprometonte rigjykimin.¹⁷

13. Prokuroria parashtrohet se “asgjë nuk ka ndryshuar” nga Vendimi i Shtatorit 2010 kur Dhoma Gjyqësore konkludoi se lirimi i të Akuzuarit përbënte rrezik konkret për dëshmitarët.¹⁸

14. Prokuroria parashtrohet se lirimi i përkohshëm i të Akuzuarit do të përbënte rrezik për dëshmitarët pavarësisht kohëzgjatjes së kërkuar të liritimit, dhe se kur i Akuzuari u lirua për dy javë gjatë pushimeve dimërore të gjykatës të vitit 2007, faktor kyç që u mor parasysh nuk ishte kohëzgjatja e liritimit të përkohshëm të kërkuar, por fakti se kishte përfunduar paraqitja e dëshmive dhe se nuk do të thirreshin më dëshmitarë për të dëshmuar.¹⁹

¹³ Po aty, para. 34.

¹⁴ Po aty, para. 30.

¹⁵ Po aty, para. 35.

¹⁶ Përgjigje, para. 1.

¹⁷ Po aty, para. 1.

¹⁸ Po aty, para. 2.

¹⁹ Po aty, para. 5; Vendim mbi Lirimimin e Përkohshëm të Lahi Brahimajt, 14 dhjetor 2007, para. 17.

15. Prokuroria thekson se frikësimi i dëshmitarëve ka qenë karakteristikë e vazhdueshme gjatë gjithë procesit²⁰ dhe se Raporti i Komisionit Evropian mbi Përparimin në Kosovë për vitin 2010, botuar më 9 nëntor 2010, konfirmon se frikësimi i dëshmitarëve vazhdon të jetë problem i madh.²¹ Prokuroria argumenton se që kur u urdhërua rigjykimi, ajo ka ndeshur në vështirësi për t'i bindur dëshmitarët brenda dhe jashtë Kosovës që të dëshmojnë.²²

16. Sipas Prokurorisë lirimi me kusht, edhe pse i përkohshëm, do të përkeqësojë atmosferën tashmë të gjithanshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe në fund të fundit do të rrezikojë të komprometojë procesin dhe kjo është sidomos e vërtetë në fazën e tanishme në vigjilje të fillimit të rigjykimit.²³

17. Prokuroria parashtro se zgjedhjet e afërme zmadhojnë rrezikun që përbën lirimi i përkohshëm i të Akuzuarit dhe se në këtë kontekst politik vendimi për të liruar të Akuzuarin do të tërhiqte vëmendjen e medias, duke kontribuar në këtë mënyrë në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve dhe në inkurajimin e përkrahësve të të Akuzuarit dhe Ramush Haradinajt për kryerjen e akteve të frikësimit.²⁴

18. Gjithashtu Prokuroria parashtro se lirimi i përkohshëm nuk duhet miratuar në qoftë se EULEX-i nuk konfirmon se do të garantojë përmbushjen e kushteve të lirimit të përkohshëm,²⁵ dhe kërkon që në rast se lirimi i përkohshëm miratohet, ai të pezullohet në bazë të Rregullës 65(E) të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”).²⁶

3. Kundërpërgjigje

19. I Akuzuari kërkon leje për t’iu kundërpërgjigjur Përgjigjes.²⁷ Ai argumenton se Prokuroria nuk ka provuar ekzistencën e ndonjë prove se ai do të përbente rrezik konkret për viktimat apo dëshmitarët.²⁸ Lidhur me Shtojcat A dhe B të Përgjigjes, i Akuzuari argumenton se informacioni në to është i paqartë dhe nuk provon se lirimi i përkohshëm i të Akuzuarit do

²⁰ Përgjigje, para. 9.

²¹ Po aty, para. 10.

²² Po aty, para. 12.

²³ Po aty, para. 12.

²⁴ Po aty, para. 13.

²⁵ Po aty, para. 15.

²⁶ Po aty, para. 16.

²⁷ Kundërpërgjigje, para. 1.

²⁸ Po aty, para. 4.

të përbënte rrezik për dëshmitarët e mundshëm.²⁹ I Akuzuari pretendon se ai personalisht nuk është përfshirë në frikësimin e dëshmitarëve dhe se pretendimi i Prokurorisë që ai është përfshirë në frikësimin e dëshmitarëve bazohet në deklaratatë të pavërtetuara dhe të paverifikuara.³⁰ I Akuzuari parashtrohet se Kosova është përgjithësisht më e qëndrueshme se në vitin 2006³¹ dhe se Raporti i Komisionit Evropian mbi Përparimin në Kosovë për vitin 2010, botuar më 9 nëntor 2010, i referohet frikësimit të dëshmitarëve në kontekst të veçantë.³² Ai parashtrohet se nuk ka asnjë provë që cilido dëshmitar i mundshëm do të ishte më pak apo më shumë i prirë për të dëshmuar gjatë rigjyqimit të pjesshëm si pasojë e pasqyrimin në media të lirimit të përkohshëm të mëparshëm ose të mundshëm të Akuzuarit në të ardhmen.³³

4. Letra e EULEX-it

20. Në letren e 6 dhjetorit 2010, EULEX-i konfirmoi se ishte i gatshëm dhe në gjendje të merrte përsipër përgjegjësitë në lidhje me lirimin e përkohshëm të të Akuzuarit që kërkohet në Mocion.³⁴ Gjithashtu letra tërhoqte vëmendjen në lidhje me faktin e karakterit evolues të rolit të EULEX-it në Kosovë ku pohohej se megjithëse mbante kompetenca ekzekutive në lidhje me hetimin e krimeve dhe procese gjyqësore të krimeve të luftës, mandati i tij nuk ishte aq i gjerë sa ai i pranisë së mëparshme ndërkombëtare të mëparshme administruar prej UNMIK-ut.³⁵

C. LIGJI PËRKATËS

21. Rregulla 65 e Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregulla 65”) parashtrohet kushtet mbi bazën e të cilëve një Dhomë Gjyqësore mund të urdhërojë lirimin e përkohshëm të të Akuzuarit. Rregulla 65 është e vlefshme si para gjyqimit po ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor. Në pjesën përkatëse të Rregullës 65 lexohet:

(A) Pas paraburgimit, i akuzuari nuk mund të lirohet veçse me urdhër të një Dhome.

²⁹ Po aty, para. 5.

³⁰ Po aty, para. 8-11.

³¹ Po aty, para. 12.

³² Po aty, para. 14.

³³ Po aty, para. 16.

³⁴ Letra e EULEX-it, f. 1.

³⁵ Po aty, f. 1.

(B) Dhoma Gjyqësore mund të urdhërojë lirim vetëm u pasi jep mundësinë për të shprehur mendimin vendit pritës dhe shtetit në të cilin i akuzuari kërkon të lirohet, dhe vetëm në qoftë se bindet se i akuzuari do të paraqitet në gjyq dhe se, po të lirohet, nuk do të përbëjë rrezik për asnjë viktimë, dëshmitar, ose person tjetër.

(C) Dhoma Gjyqësore mund të vendosë kushte që i gjykon të nevojshme për lirim, ndër të cilat përmbushjen e një fletëgarancie dhe respektimin e kushteve të nevojshme që mundësojnë praninë e të akuzuarit në procesin gjyqësor si edhe mbrojtjen e të tjerëve.

22. Rregulla 65 më tej parashtron se Prokurori mund të kërkojë pezullimin e një vendimi nga Dhoma Gjyqësore për lirim e një të akuzuari me arsyetimin se Prokurori synon të apelojë vendimin dhe bën një kërkesë të tillë në kohën kur dorëzon përgjigjen e tij ose të saj ndaj kërkesës fillestare prej të akuzuarit për lirim të përkohshëm.

D. DISKUTIM

1. A do të paraqitet i Akuzuari në gjykim

23. Në Vendimin e Shtatorit 2010, Dhoma Gjyqësore u bind se i Akuzuari do t'i dorëzohej Tribunalit kur të urdhërohej ta bënte këtë.³⁶ Që nga Vendimi i Shtatorit 2010 nuk është paraqitur asnjë provë që do të sugjeronte se po të lirohej, i Akuzuari nuk do të paraqitej në gjykim. Për më tepër, EULEX-i konfirmoi se ishte i gatshëm dhe në gjendje të merrte përsipër përgjegjësitë në lidhje me lirim e përkohshëm të të Akuzuarit që kërkohet në Mocion.³⁷ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore është e bindur se i Akuzuari do të paraqitet në gjykim.

2. Në qoftë se lirohet, a do të përbëjë i Akuzuari rrezik për viktimë, dëshmitarë apo persona të tjerë

24. Sipas jurisprudencës së Tribunalit, për të vlerësuar nëse i Akuzuari do të përbënte rrezik për viktimë, dëshmitarë apo persona të tjerë, “është e nevojshme të identifikohet rreziku konkret”, dhe ky vlerësim nuk mund të “jetë abstrakt”.³⁸

³⁶ Vendimi i Shtatorit 2010, para. 26-29.

³⁷ Letra e EULEX-it, f. 1.

³⁸ Vendimi mbi Mocionin në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 20 korrik 2007, para. 17; *Prokurori k. Haxhihasanoviqit dhe të tjerëve*, Vendim që Miraton Lirim e Përkohshëm të Enver Haxhihasanoviqit, Dhoma Gjyqësore, 19 dhjetor 2001, para. 11; Vendimi mbi Mocionin në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 6 qershor 2005, para. 22; *Prokurori k. Stanishiqit*, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm të Prokurorisë ndaj Lirimit të Përkohshëm të Miqo Stanishiqit, Dhoma e Apelit, 17 tetor 2005, para 27.

25. Më 3 maj 2006, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi provat konfidenciale të UNMIK-ut lidhur me sjelljen e të Akuzuarit dhe konstatoi se:

“Tërësia e provave, ndryshe nga vlerësimi i incidenteve veç e veç, krijon dyshim të ndjeshëm se po të lirohej përkohësisht, i Akuzuari nuk do të silllej në mënyrë që nuk do të përbënte kërcënim për viktimat dhe dëshmitarët e mundshëm në këtë çështje.”³⁹

Në bazë të këtyre provave, Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë Mocionin e të Akuzuarit duke gjykuar se ai nuk i përmbushte kushtet e përcaktuara në Rregullën 65(B).

26. Në Vendimin e shtatorit 2010, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi Vendimin e 14 dhjetorit 2007⁴⁰ dhe atë të 25 majit 2009⁴¹ ku ishte miratuar kërkesa e të Akuzuarit për lirim të përkohshëm.⁴² Në Vendimin e dhjetorit 2007, Dhoma Gjyqësore konkludoi se rreziku që përbënte i Akuzuari për dëshmitarë të mundshëm ishte dukshëm më i paktë për arsye se gjykimi kishte hyrë në fazë të re ku Prokuroria kishte përfunduar procedimin e çështjes dhe Mbrojtja nuk do të paraqiste çështjen e saj.⁴³ Në vendimin e majit 2009, Dhoma e Apelit mori mocionin e të Akuzuarit për lirim të përkohshëm kur ai deri në atë moment kishte vuajtur pothuajse dy të tretat e dënimit të tij me burgim⁴⁴ dhe gjykoi se nuk kishte të ngjarë që i Akuzuari të përbënte rrezik për dëshmitarë të mundshëm në atë fazë të gjykit, meqë përfundimi i apelit ishte i paparashikueshëm dhe rigjykimi ishte vetëm një nga përfundimet e mundshme.⁴⁵ Rrethanat e tanishme janë të ndryshme duke qenë se përgatitjet për rigjykimin kanë përparuar dhe dëgjimi i dëshmitarëve të Prokurorisë pritet që të fillojë së shpejti.

27. Dhoma Gjyqësore nuk gjen arsye për të ndryshuar përfundimin e saj në Vendimin e Shtatorit 2010 se pozita e dëshmitarëve gjatë rigjykit të pjesshëm do të jetë shumë delikate dhe se në këtë kuadër, pretendimet të cilat çojnë në dyshimin material për sjelljen e të Akuzuarit në lidhje me viktimat dhe dëshmitarët e mundshëm, përbëjnë shqetësim

³⁹ Përgjigje, para. 2. Shih gjithashtu Vendimin e Mëtejshëm mbi Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 3 maj 2006 (“Vendimi i majit 2006”), para. 41.

⁴⁰ Vendimi mbi Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 14 dhjetor 2007 (“Vendimi i dhjetorit 2007”), para. 17.

⁴¹ Vendimi mbi Kërkesën e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 25 maj 2009 (“Vendimi i majit 2009”).

⁴² Vendimi i shtatorit 2010, para. 32-34.

⁴³ Vendimi i dhjetorit 2010, para. 17.

⁴⁴ Vendimi i majit 2009, para.

⁴⁵ Po aty, para. 14.

edhe më të madh.⁴⁶ Lidhur me sa më sipër, Dhoma Gjyqësore konstaton se frikësimi i dëshmitarëve vazhdon të jetë problem në Kosovë në përgjithësi⁴⁷ dhe se që kur u urdhërua rigjykimi, Prokuroria ka ndeshur vështirësi për t'i bindur dëshmitarët që të dëshmojnë.⁴⁸ Dhoma Gjyqësore më tej vë në dukje ekzistencën e provave se frikësimi i dëshmitarëve gjatë gjyqimit i kaloi kufijtë e Kosovës dhe se dëshmitarë të cilët banojnë në Kosovë mund të thirren për të dëshmuar gjatë rigjyqimit.⁴⁹

28. Në Vendimin e Shtatorit 2010, Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësi kohëzgjatjes së lirimit të përkohshëm që kërkohej dhe konstatoi se kohëzgjatja ende e papërcaktuar e lirimit të përkohshëm deri në fillimin e rigjyqimit të pjesshëm e zmadhon rrezikun e mundshëm për viktimë, dëshmitarë apo të tjerë.⁵⁰ Në Mocionin e Akuzuarit kërkon librim të përkohshëm vetëm për tri javë. Ky është dallimi kryesor midis rrethanave të kërkesës së tashme dhe asaj që u hodh poshtë me Vendimin e Shtatorit 2010. Dhoma Gjyqësore përfundon se për shkak të kohëzgjatjes së lirimit të përkohshëm që kërkohet, rreziku i mundshëm është më i paktë, krahasuar me atë të kohës së Vendimit të Shtatorit 2010. Mirëpo Dhoma Gjyqësore është e mendimit se ndonëse rreziku për viktimë, dëshmitarë apo të tjerë që do të përbënte librimin e përkohshëm të Akuzuarit është i kufizuar për arsye të periudhës së shkurtër të lirimit të përkohshëm që kërkohet, rreziku ende nuk është zhdukur.

29. Për këto arsye Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur se nëqoftëse lirohet, i Akuzuari, nuk do të përbëjë rrezik për viktimë, dëshmitarë apo persona të tjerë dhe rrjedhimisht konkludon se kushtet e Rregullës 65 (B) nuk janë përmbushur.

E. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura dhe në përputhje me Rregullat 65 dhe 126 *bis*, Dhoma Gjyqësore **MIRATON** librimin e të Akuzuarit për kundërpërgjigje dhe **HEDH POSHTË** Mocionin.

⁴⁶ Vendimi i Shtatorit 2010, para. 35.

⁴⁷ Përgjigje, para. 10. *Krahaso* Përgjigje, Shtojca A, Raporti i Komisionit Europian mbi Përparimin në Kosovë për vitin 2010, 9 nëntor 2010, f.11, 56.

⁴⁸ Përgjigje, para. 12.

⁴⁹ Vendimi i shtatorit 2010, para. 35.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 8 dhjetor 2010.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

⁵⁰ Vendimi i shtatorit 2010, para. 36.